

**LIGJ**  
**Nr. 67/2016**

**PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT TË TRAKTATIT TË ATLANTIKUT VERIOR**  
**PËR ADERIMIN E MALIT TË ZI**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokollin e Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Malit të Zi, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.6.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9678, datë 4.7.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**  
**Bujar Nishani**

**PROTOKOLL I TRAKTATIT TË ATLANTIKUT VERIOR**  
**PËR ADERIMIN E MALIT TË ZI**

Palët e Traktatit të Atlantikut Verior kanë nënshkruar në Uashington më 4 prill 1949.

*Duke qenë të bindura se siguria e zonës së Atlantikut Verior do të rritet me aderimin e Malit të Zi në këtë Traktat,*

bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Me hyrjen në fuqi të këtij Protokollin, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior, i njofton Qeverisë së Malit të Zi, në emër të të gjitha Palëve, ftesën për t'u pranuar në Traktatin e Atlantikut Verior. Në përputhje me nenin 10 të Traktatit, Mali i Zi bëhet Palë në datën kur depoziton instrumentin e saj të aderimit te qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Neni 2

Ky Protokoll hyn në fuqi kur secila nga Palët e Traktatit të Atlantikut Verior ka njoftuar qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për pranimin e saj. Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës informon Palët e Traktatit të Atlantikut Verior mbi datën e marrjes së këtij njoftimi, si dhe datën e hyrjes në fuqi të këtij Protokollin.

Neni 3

Ky Protokoll, ku tekstet në gjuhën angleze dhe frënge janë njëloj autentike, depozitohet në Arkivat e qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kopjet e njësuar me Protokollin dërgohen nga qeveria e SHBA-ve te qeveritë e të gjitha Palëve të Traktatit të Atlantikut Verior.